

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandali i madh në SHISH/ Kalaja: SPAK po publikon vetëm mesazhet erotike, po mundohet të fshehë t ë vërtetën
ADRESA	https://piranjat.al/politike/skandali-i-madh-ne-shish-kalaja-spak-po-publikon-vetem-mesa-zhet-e-i105773
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 08:46:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 08:35:01 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cd4d6fa1c08563965470c8a2666cc414f6009dc6c36e0cb3aac460c8e535005d
TEKSTI	6f64aa36139f1b8c5a23de37488465a807704244524227fe02b913bf5292c1f7
PAMJA	fdda3a9063d02750fc9fa621c8e974329483f163daec543cbf5ece496e3754f6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	31a402b326a6cbbf0581975db3faf31a8257a00960fdf7bd20a55567687605b6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9a6b20a4f7bca7d38b85ed38d229f05609a1ca606edde02ba3c9e62d673a221c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/31a402b326a6cbbf0581975db3faf31a8257a00960fdf7bd20a55567687605b6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

**vetëm
mesazhet**

emisioni e
mëngjesit
'Kafe
Shqeto' në

**gjuhën e
Ramës:**

Kuvendit
lidhur me
arrestimin

**agresionin e
krimin.**

kryeministri
i Kosovës,
Albin Kurti,
ka kujtuar

**për
qeverinë**

te
inteligjencës
është nën
arrest

**yunë në
dispozicion**

ndërmun ka
është
përfshirë
biznesmeni

[POLITIKE](#)

Skandali i madh në SHISH/ Kalaja: SPAK po publikon vetëm mesazhet erotike, po mundohet të fshehë të vërtetën

Piranjat Përditësimi i fundit 24 Shtator 2026, 10:35



Juristja Adriana Kalaja ka qene e ftuar në emisionin e mëngjesit 'Kafe Shqeto' në Syri tv. Ajo në bisedë me moderatorin Flavio Qarri ka komentuar zhvillimet e fundit pas skandalit të SHISH dhe vënien në shërbim për bandat e krimit dhe trafikantëve të kësaj strukture të rëndësishme shtetërore.

Adriana Kalaja: Në rastin konkret. Nuk është faji as i Ergys Agasit, as i Vlora Hysenit, as i Belinda Ballukut. Strumbullari i gjithë kësaj piramide kriminale është Edi Rama. Janë provat në dosje.

Unë po e nis pak nga fundi. Një kompetencë që nuk është e kryeministrit pse duhet ta përdori kryeministri, të na e hedhi ne në publik se unë mora masa. Ku e ka tagrin kryeministri për të shkarkuar kryetarin e SHISH. As për ta emëruar, as për ta shkarkuar. E thotë ligji. E ka një palo president që është në atë post për turpin tonë të gjithëve. Sepse kryeministri e thotë ligji, vetëm e propozon. Përveçse atij që nuk e zë gjumi për hallet e Shqipërisë, pikërisht ditën që do të arrestohej Vlora Hyseni atë e kishte zënë gjumi në Amerikë. Aq më shumë që të dhënat e sakta konfirmojnë që jo vetëm Vlora Hyseni e dinte këtë që do të ndodhte, por kishte një garanci maksimale edhe Edi Rama që do të ndodhte kjo gjë. Pra kishte informacionin e saktë. Dhe për këtë i ka kërkuar dorëheqje që vendimi i masës të mos ekzekutohej në kohën që ajo kishte mandat. Pra për të dhënë, Shikoni ne e larguam nga posti. Dhe unë i bëj thirrje të gjithë mediave sidomos publikut të ndershëm, mua personalisht nuk më pëlqen fare dhe jam kundra kësaj që një ngjarje kaq e rëndë...

Sepse shikoni çfarë po bën SPAK. Nuk nxjerr mesazhet që duhet te nxjerrë që kanë të bëjnë me sekretet shtetërore, çfarë janë këto sekrete shtetërore, kush i ka sot që po flasim. A i përdori ndonjëherë Ergys Agasi dhe bandat kriminale këto sekrete shtetërore. A është përdorur SHISH për të fshehur...

Spese në 500 e ca mesazhe, video, dhe telefonata ti nuk mund të qëmtosh 5 SMS erotike, dhe na i hedh ne në publik për të na treguar...Sepse kjo është narrativa që po përpiqet ai banditi kryeministër i pari. Narativa që po ngrihet fatkeqësisht në bashkëpunim me SPAK-un

Flavio Qarri: Është një histori rozë...

Adriana Kalaja: Ashtu. Po dashuria është e madhe, shkelet dhe detyra, shpërdorohet edhe detyra për dashurinë që kjo kishte për Ergysin.

Flavio Qarri: Po e paskan dashur shumë...

Adriana Kalaja: Edhe ajo e kadastrës që nuk mund të quhet Dallandyshe. Është edhe Linda e AKSH, është edhe Belinda. Xhelozirat e njera tjetrës. Dhe pavarësisht se eksponentëve të PS mund tu duken si perceptime, këto tashmë janë të faktuara sepse jo me kot merren pikërisht me këto komunikimet rozë se sa me faktin që ata e dinë shumë mirë, që e gjitha kjo që po ndodh është për shkak të presionit të madh që po bën lobi i të pandehurës Belinda Balluku që i gjithë fokusi i SPAK dhe i gjithë fokusi i opinionit publik të zhvendoset tek dosja e AKSH-it dhe jo tek dosja e të pandehurës Belinda Balluku. Dhe ne e dimë shumë mirë, mirë mbase edhe se eksponentët. Sepse kur me vijnë grupet e Belidnës, bëj një denoncim për kundërshtarët apo të tjerë...Ne nuk duhet të merremi me faktin që çfarë ka patur në aspektin personal...

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 24 Shtator10:22

PD kërkon ndryshimin e rendit të ditës në Kuvend pas masës së SPAK ndaj Vlora Hysenit

Partia Demokratike ka kërkuar ndryshimin e rendit të ditës në Kuvend, pas zhvillimeve të fundit lidhur me arrestimin e ish-drejtoresh...

Nga Genc Pollo POLITIKE 24 Shtator09:49

Si kontrasti Guillaume/Hyseni shpjegon Shqipërinë 2026

Të thuash se KM Rama duhet të dorëhiqet mbasi është ai që e emëroi Vlora Hysenin shefe të Shërbimit Informativ &e...

POLITIKE 24 Shtator09:38

“Krizë më serioze e sigurisë kombëtare”, Le Monde: Tronditje për qeverinë Rama, e goditur disa herë nga skandale korrupsioni

Le Monde Në Shqipëri, kreu i shërbimeve të inteligjencës është nën arrest shtëpiak në lidhje me një sk...

POLITIKE 24 Shtator09:22

Çmimet stratosferike në Shqipëri, Kedhi: Jemi në një krizë të madhe, ekonomike, sociale e demografike

I ftuar në emisionin të mëngjesit ‘Kafe Shqeto’ në Syri tv ishte nënkryetari i Partisë Demokratike Nikola Kedhi. N&...

POLITIKE 24 Shtator07:50

Opozita interpelancë me Jaupajn e Kumbaron, diskutime edhe për dërgimin e trupave ushtarake në Gaza (Rendi i ditës)

Kuvendi i Shqipërisë do të mbledhet sot, në orën 10:00, në seancën e radhës plenare. Në rendin e ditës janë &e...

POLITIKE 23 Shtator21:27

“Skandale të tjera” paralajmëron deputeti: Së shpejti do dalin përgjimet ku kanë shkuar lekët e inceneratorëve

Deputeti i Partisë Demokratike, Gjini Gjoni, ka paralajmëruar publikimin e të dhënave të reja që, sipas tij, lidhen me aferën ...

POLITIKE 23 Shtator20:51

‘Skandal me sfond romantik në Shqipëri’/ Gazeta e madhe greke artikull për akuzat ndaj Vlora Hysenit dhe Agasit. Çfarë shkruan për Ramën

“Zemra ime, thjesht duhet të përqendrohemi te problemi yt... Të gjithë ne. Do të përfundojmë keq, shpirti im.&rdqu...

POLITIKE 23 Shtator20:26

“Po mbrohet Vlora Hyseni”, Berisha: SPAK nuk e cilëson anëtare të grupit të strukturuar kriminal

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, akuzoi sot, pas mbledhjes së Kryesisë së PD-së, SPAK-un se po mbron ish-drejtoreshën e S...

POLITIKE 23 Shtator20:16

“Arrestimi i Vlora Hysenit, kambanë alarmi”/ Aktivistja: Nga Agasi te Balluku e Tahiri, korrupsioni është bërë me urdhër të Ramës!

Aktivistja Sidorela Vatnikaj foli në protestën e 116-të në lidhje me zhvillimet e fundit në kryeqytet. Ajo shprehet, se pas gjithë...

POLITIKE 23 Shtator19:42

Berisha: Bojkoti do ishte avantazh për Ramën, ne do i japim atij përgjigjet më të forta në parlament

Gjatë fjalës në kryesinë e PD-së, lideri i demokratëve Sali Berisha u shpreh se, në mbledhje e gjatë të grupit parl...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 23 Shtator

Skandal/ Kreu i SHISH mesazh Agasit: Zemër, duh...

Më 18 shtator, Vlora Hyseni është marrë në pyetje nga agjentët e Byrosë Kombëtare të Hetimit si person në di...

AKTUALITET 23 Shtator

U vra nga pronari italian i banesës, del autops...

Pak ditë pas vrasjes së 36-vjeçarit shqiptar Gjovalin Lazri nga pronari italian i një banese, mediat italiane japin të tjera detaje p...

["O shpirt, nesër do takoj Kryeministrin"/ Zbard...](#)

Komunikimet e zbuluara mes ish-drejtuës së Shërbimit Informativ Shtetëror, Vlora Hyseni, dhe Ergys Agasit zbulojnë një tërësi...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator 11:40

[EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja "mbysin" Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnamit ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro](#)

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1






PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1




“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit





Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.